

Bashkëjetesa me Gazsjellësin TAP Të drejtat dhe kufizimet mbi tokën në afërsi të tubacionit TAP

Faza e Operimit të Gazsjellësit

Gjatë gjithë kohës, ne jemi të përkushtuar që të mbrojmë njerëzit, komunitetin dhe mjedisin nga çdo dëmtrim, duke u mbështetur në standardet më të larta ndërkombëtare dhe praktikën më të mirë të industrisë.

Përgjatë korridorit të kalimit, TAP-i ka vendosur sinjalistikë mbi tokë për të shënuar gjurmën e gazsjellësit.

Gjatë Fazës së Operimit, TAP-i dhe kontraktorët e tij do të kryejnë **inspektime rutinë të tubacionit dhe punime mirëmbajtjeje**.

Për kryerjen e aktiviteteve të inspektimit dhe mirëmbajtjes, TAP-i ka nevojë për **akses të pakufizuar dhe të papenguar përgjatë korridorit të kalimit të gazsjellësit, në zonën e sigurisë, të quajtur Zona A**.

Në rast të një alarmi, **TAP-i do të adresojë në kohë çdo incident** lidhur me operimin e tubacionit.



Siguria është prioriteti numër një për Gazsjellësin Trans Adriatik, TAP. Ju lutemi, mos ndërmerrni asnjë aktivitet që mund të vërë në rrezik operimin e sigurt të gazsjellësit.

Linja e Emergjencës-0800 1659

Ju lutemi, kontaktoni Linjën e Emergjencës së TAP-it në numrin e telefonit 0800 1659 (pa pagesë), nëse ndeshni aktivitetet e mëposhtme në zonën e sigurisë së TAP:

Në rast se keni filluar punime dhe ndesheni me tubacionin, ndaloni punimet dhe na telefononi menjëherë!
TAP-i do t'iu vërë në dispozicion informacion, udhëzime dhe/ose do të dërgojë një ekip teknik në terren.

- Aktivitete ndërtimi.
- Dëmtrim, vandalizëm, ose prishje të tubacionit, të sinjalistikës.
- Përmbytje, rrëshqitje të tokës, erozion.
- Persona të paautorizuar që hyjnë në korridorin e kalimit ose në pjesë të tjera të infrastrukturës së gazsjellësit.
- Zjarre ose djegie e pakontrolluar.

TAP-i ka një procedurë për reagimin ndaj emergjencave dhe punon ngushtë me shërbimet e emergjencës, si në nivel vendor edhe në atë kombëtar.

Linja e Informimit dhe Ankesave-069 60 98 188

Përpara se të ndërmerrni ndonjë aktivitet në afërsi tubacionit, jeni të lutur që të pyesni TAP dhe të merrni informacionin e saktë se çfarë lejohet në zonën e sigurisë. Telefononi në numrin **+355 69 609 8188** para se të veproni.

www.tap-ag.com



Trans Adriatic
Pipeline

Pyet TAP
përpara se të
gërmosh



Emergjenca
0800 1659

Informacion
0696098188

Punimet në afërsi të infrastrukturës së TAP-it

Tubacionet janë një infrastrukturë e besueshme dhe e sigurt e transportimit të gazit natyror. Megjithatë, nëse jetoni në afërsi të tubacionit të TAP duhet të dini disa rregulla të rëndësishme.

Ju lutemi që të kontaktoni TAP përpara se të kryeni aktivitete mbi ose nën tokë në afërsi të Zonës së Konsultimit dhe Zonës së Sigurisë. Këto zona rregullohen me legjislacionin shqiptar (Ligji Nr. 116/2013).



Zona A - Brezi Mbrojtës

me një korridor kalimi 8 metra të gjerë (4 metra në secilën anë të tubacionit)

Lejohet

- Kultivimi i kulturave bujqësore dhe bimëve të tjera me rrënjë që nuk shkojnë më thellë se 60 cm.
- Kullotja e kafshëve.
- Pasurimi i tokës në sipërfaqe, plehërimi, dhe mbjellja e farave për kullota.
- Mbajtja në kontroll e barërave të këqija me mënyra që nuk ndërhyjnë në morfologjinë e dheut.
- Aktivitete argëtuese si ngjitje mali, ecje në natyrë ose kalërim.

Ndalohe

- Ndalohe ndërtimi i ndërtesave të çfarëdolloj natyre, qofshin gardhe, struktura mbrojtëse apo pengesave të tjera mbi pronën.
- Ndalohe ndryshimi i relievit të pronës.
- Ndalohe ndryshimi i morfologjisë së tokës; si gërmimi/plugimi i thellë, shpimi i puseve ose hapja e kanaleve ujitëse.
- Ndalohe mbjellja e pemëve ose bimëve me rrënjë që shkojnë më thellë se 60 cm.
- Ndalohe ndezja e zjarreve.
- Ndalohe krijimi i pellgjeve ose krijimi i kushteve për grumbullimin e ujit.

Zona B - Zona e Sigurisë

me një korridor kalimi 40 metra të gjerë (20 metra në secilën anë të tubacionit dhe duke respektuar ndalimet e Zonës A)

Lejohet

- Kultivimi i bimëve dhe pemëve të çfarëdo lloji.
- Kullotja e kafshëve.
- Transportimi ose kalimi i mjeteve ose makinerive.

Ndalohe

- Ndalohe ndërtimi i strukturave dhe godinave të çdo natyre.
- Ndalohe instalimi i sistemeve të shkarkimit ose depozitimeve të përherëshme që ndryshojnë morfologjinë e tokës.
- Ndalohe ndërtimi i rrugëve të reja rurale ose i infrastrukturave të tjera publike pa marrë më parë miratimin e TAP-it.
- Ndalohe dëmtimi ose heqja e sinjalistikës së TAP.

